

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6941
E mërkurë, 12 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Çitaku: Hashim Thaçi
disa i tremb edhe
nga burgu! FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NDËRKOMBËTARËT INSISTOJNË PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS FAQE 3

NATO-ja DHE SHBA-ja PËRSËRI BËJNË THIRRJE PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI



Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleanca veriatlantike është e shqetësuar për situatën në veri të Kosovës. Ai në nisje të samitit dyditor të NATO-s në Vilnius të Lituanisë ka bërë thirrje për shtensionimin e situatës në veri. Lidhur me shtensionimin e situatës

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka folur edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Ai ka thënë se e ka vështirë ta thotë se janë afër shtensionimit të situatës. Hovenieri ka theksuar se veriu është i komplikuar dhe mënyra se si Qeveria e Kosovës është duke e menaxhuar situatën atje është

shumë e ndjeshme. Në këtë kontekst, Hovenier ka thënë se ShBA-ja dëshiron që Kosova të jetë e koordinuar me aleatët ndërkombëtarë në mënyrë që të shmangen momentet e krizës që "pengojnë rrugën tonë të gjatë për të arritur këtë qëllim të përbashkët"

AKTUALE



SHBA-ja SANKSIONON
ALEKSANDËR VULININ F. 2

GJERMANIA PRITET TË VENDOSË
MASA EDHE NDAJ SERBISË F. 5

OSMANI: DËNOJMË PËRPJEKJET
PËR MOHIMIN E GJENOCIDIT NË
SREBRENICË, PO RRIEN
TENDENCAT PËR DESTABILIZIM F. 6

EKONOMI



HOVENIERI: SHBA-ja ËSHTË E
PËRKUSHTUAR QË TË RINJTË TË
GJEJNË PUNË NË KOSOVË F. 8

HAJDARI: ZONAT EKONOMIKE
S'KANË QENË TËRHEQËSE PËR
INVESTITORË F. 8

SPORT



GLIHA PAS TAKIMIT ME ADEMIN:
DO T'IA RIKTHEJ KOSOVËS
REZULTATET POZITIVE F. 10



**ABDIXHIKU KËRKON
ZGJEDHJE TË REJA
NË VERI DHE MOBILIZIM
PËR HARTIMIN E
DRAFT-STATUTIT
TË ASOCIACIONIT** FAQE 3

**'REMI' THOTË SE I
KA CAKTUAR VETË
ZYRTARËT PËR
INFORMIM NË
ZONËN OPERATIVE
TË UÇK-së NË LLAP** FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja sanksionon Aleksandër Vulinin

UASHINGTON, 11 KORRIK - Drejtori i Agjencisë për Siguri dhe Informacion i Serbisë (BIA), Aleksandër Vulin, është futur në listën e sanksioneve amerikane, ka bërë me dije Zyra për Kontrollin e Aseteve të Huaja në Departamentin Amerikan të Thesarit. Sipas Thesarit, Vulin është përfshirë në afëra korruptive për "t'i shtyrë përpara agjendat e tij politike dhe interesat e tij personale në kurriz të paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor". "Këto marrëveshje korruptive lehtësuan aktivitetin malinj rus në Serbi dhe rajon", është thënë në njoftim.

Sipas njoftimit të Thesarit, Vulin është përfshirë në krim të organizuar transatlantik, në operacionet jologjore narkotike dhe në keqpërdorim të detyrës zyrtare. "Vulini ka mbajtur raporte që kanë pasur përfitim reciprok me trafikantin e

armëve, Slobodan Teshiq, duke mundësuar që dërgesat me armë të tij të mund të lëvizin lirshëm përtej kufijve të Serbisë", është thënë në këtë njoftim.

Teshiq është në listën e zezë amerikane që nga viti 2017. Thesari e ka akuzuar Vulinin se ka "avancuar" korrupsionin brenda institucioneve qeverisëse serbe. Këtu, sipas Uashingtonit, përfshihet edhe përdorimi i autoritetit për përfitim personal "sikurse përfshirja në një rrjet të trafikimit të drogës". "Ai ka përdorur pozitat publike për ta mbështetur Rusinë, për ta lehtësuar aktivitetin malinj të Rusisë që degradon sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe i ofron Rusisë një platformë për ta përhapur më tej ndikimin e saj në rajon", është thënë në njoftimin e Departamentit Amerikan të Thesarit.

Vulini më herët ka shërbyer ministër i Mbrojtjes dhe i Brendshëm në Serbi. Departamenti Amerikan i Thesarit tha se nuk do të hezitojë që t'i shënjestrojë aktorët "që abuzojnë me pozitat e tyre për të përfituar duke minuar qeverisjen efektive dhe demokratike në Ballkanin Perëndimor". "Veprimet e sotme mbajnë përgjegjës Aleksandër Vulinin për veprimet e tij korruptive dhe destabilizuese që, po ashtu, kanë lehtësuar aktivitetet malinje të Rusisë në rajon", tha nënkretari i Thesarit për Terrorizëm dhe Inteligjencë Financiare, Brian E. Nelson.

Vendosja e sanksioneve nënkupton që të gjitha pronat që Vulin mund të ketë në ShBA, apo që kontrollohen nga qytetarë amerikanë, do të bllokohen. Po ashtu, atij i ndalohet të bëjë transaksione me shtetasit amerikanë.



Pas mbështetjes për Suedinë, Turqia pret hapa konkretë për anëtarësim në BE

ANKARA, 11 KORRIK - Turqia pret ringjalljen e një grupi reformash në Bashkimin Evropian pasi Ankaraja ta miratojë anëtarësimin e Suedisë në NATO, ka thënë një zyrtar i lartë turk për agjencinë e lajmeve "Reuters" të martën. Turqia, me këtë lëvizje dhe kërkesë, kërkon të hyjë në një periudhë të re të lidhjeve të përmirësuar me Perëndimin. Ankaraja pret që të fillojë të ketë përparim konkret nga ana e Bashkimit Evropian për çështje të tilla si udhëtimi pa viza, si dhe mbyllja e disa kapitujve për pranimin në BE, ka thënë zyrtari, duke shtuar se Perëndimi duhet ta mbështesë Turqinë në nevojat e saj financiare. Turqia do të zhvillojë një marrëdhënie "të arsyeshme" me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pret zgjidhjen e shpejtë të disa problemeve, edhe pse të gjitha çështjet mund të mos zgjidhen, tha zyrtari. Megjithatë, ai ka thënë se Ankaraja nuk do t'i dëmtojë marrëdhëniet e saj me Rusinë teksa vendi afrohet me Perëndimin.

Bisedimet e anëtarësimit të Turqisë rifilluan në vitin 2005



nën mandatin e parë të Rexhep Tajip Erdoganit kryeministër. Përpjekja e Ankarasë për t'iu bashkuar BE-së ka qenë të ngrira prej vitesh.

Vendet anëtare kishin votuar për t'i pezulluar bisedimet për këtë çështje në vitin 2016, pasi qeveria e Erdoganit pati goditur ashpër kundërshtarët, pas një përpjekjeje të dështuar për një grusht-shtet në të njëjtin vit.

Blloku varet nga ndihma e aleatit të NATO-s, Ankarasë, sidomos për ndalimin e emigrantëve të paligjshëm.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, më 10 korrik është pajtuar që ta mbështesë anëtarësimin e Suedisë në NATO, edhe pse më herët gjatë ditës ai kushhtëzoi pranimin e Suedisë në këmbim të anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian.

Në deklaratën e lëshuar pas takimit trepalësh me NATO-n është thënë se Turqia dhe Suedia do të punojnë ngushtë "në koordinimin e kundërterrorizmit" dhe do t'i fuqizojnë raportet dypalëshe tregtare. "Suedia do t'i mbështesë në mënyrë aktive përpjekjet për ta ringjallur procesin e pranimit të Turqisë në BE, përfshirë edhe modernizimin e bashkimit

doganor BE - Turqi dhe liberalizimin e vizave", është thënë në deklaratë.

Që një shtet të bëhet anëtar i NATO-s duhet që të 32 shtetet t'i ratifikojnë në parlamentet e tyre protokollet e pranimit. Në rastin e Suedisë, përveç Turqisë, edhe Hungaria nuk e ka ratifikuar protokollin që Stokholmi të bëhet pjesë e aleancës.

Pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Suedia dhe Finlanda kanë aplikuar për anëtarësim në NATO në maj të vitit 2022. Finlanda është bërë anëtare e aleancës në prill të vitit 2023.

Marrëveshja në mes të Suedisë dhe Turqisë ka ardhur një ditë para nisjes së samitit dyditor të NATO-s, që do të mbahet në Vilnius të Lituanisë. Ky samit pritet të dominohet nga lufta në Ukrainë dhe raportet që aleanca do të ketë në të ardhmen me Kievin. Pavarësisht se Ukraina dëshiron që NATO të bëjë hapa drejt anëtarësimit të Kievit në aleancë, Stoltenbergu ka thënë se nuk do t'i dërgohet ftesë Ukrainës për anëtarësim për aq kohë sa vazhdon lufta me Rusinë, po ka kërkuar lehtësim të procedurave.

Blinkeni: Qëndrojmë me popullin e Bosnjës në ndjekjen e drejtësisë për viktimat

Uashington, 11 korrik - Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në 28-vjetorin e gjenocidit ka kujtuar viktimat e masakrës së Srebrenicës. Blinkeni ka thënë se ShBA-ja qëndron me popullin e Bosnjë-

Hercegovinës në ndjekjen e vazhdueshme të drejtësisë për viktimat. "Në 28-vjetorin e gjenocidit të Srebrenicës, ne kujtojmë të gjitha viktimat e tij dhe qëndrojmë me popullin e Bosnjë-Hercegovinës në

ndjekjen e vazhdueshme të drejtësisë për viktimat dhe të dashurit e tyre", ka shkruar Blinkeni në "Twitter".

Të martën janë varrosur 30 viktima të gjenocidit në Srebrenicë.



Abdixhiku kërkon zgjedhje të reja në veri dhe mobilizim për hartimin e draft-statutit të Asociacionit

Prishtinë, 11 korrik - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, pas takimeve që ka pasur me shoqërinë civile dhe OJQ-të, në të cilat është diskutuar për gjendjen politike në vend, me theks të veçantë relacionet e Kosovës me aleatë, ka thënë se nga takimet e deritashme janë përkrahur idetë që ka shpalosur kjo parti. Ai ka kërkuar zgjedhje të reja në katër komunat në veri të Kosovës dhe formimin e një ekipi për hartimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Abdixhiku ka thënë se në këtë takim kanë paraqitur edhe idenë që Kosova do të ndërtojë një ekip profesionistësh, ekspertësh të rendit kushtetues, të drejtës juridike, arsimit, kulturës dhe zhvillimeve ekonomike. “Mbi 20 organizata të shoqërisë civile i janë përgjigjur pozitivisht ftesës sonë dhe në takimin që zgjati pothuajse tri orë folëm hapur për gjendjen e tanishme politike në vend, mbi të gjitha për rrugën që duhet dalë përpara. Jam jashtëzakonisht i lumtur jo vetëm për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, por edhe për mendimet e hapura përmbajtjesore dhe thelbësore në atë që po shtrijmë tani”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka thënë se si LDK kanë paraqitur shtatë pika “për rrugën përpara”. Sipas tij, dëmtimi i Kosovës po i bëhet nga “politikat e gabuara, përplasëse e të papracedenta të kryeministrit Albin Kurti dhe paaftësisë së

jashtëzakonshme të MPJ-së”. “Si LDK ne prezantuar dhe shtatë pika tona, të njëjtat që kemi prezantuar javën e kaluar tek opinionistët dhe gazetarët. Për LDK-në gjendja e tanishme kërkon shtensionim, kërkon zgjedhje të reja sa më parë të jetë e mundur në veri të vendit, me qëllim të kthimit të legjitimitetit tek institucionet lokale në katër komunat veriore, legjitimitet i dëmtuar për shkak pjesëmarrjes së ulët të serbëve lokalë atje dhe zgjedhjet e reja duhet të organizohen nëpërmjet marrëveshjes politike në mes të LV-së, PDK-së dhe katër kryetarëve aktualë atje për dorëheqjen e tyre dhe shkaktim të zgjedhjeve brenda periudhës 45-ditëshe. Si pikë e dytë kjo periudhë 45 ditore do të shërbejë për institucionet e Kosovës, por në veçanti për komunitetin ndërkombëtar me të cilin po ashtu po komunikojmë në vazhdimësi për bindjen e serbëve për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme të jashtëzakonshme në veri të vendit. Pozicioni i Kosovës ndërkombëtarisht është i dëmtuar jo vetëm për shkak të politikave të gabuara, të papracedente të kryeministrit Kurti dhe Qeverisë së Kosovës me aleatët tanë, por edhe paaftësisë së jashtëzakonshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ne mendojmë se Kosova duhet të ndërtojë ekupe profesionistësh, diplomatësh me përvojë që të dërgojë në çdo kryeqendër evropiane dhe botërore në ato



kryesoret për të kërkuar jo vetëm heqjen e dënimeve, masave sanksionuese ndaj Republikës së Kosovës, por edhe për t'i parashtruar hapat e ardhshëm të vendit”, ka thënë ai.

Më tutje, Abdixhiku ka thënë se Kosova duhet të krijojë ekupe profesionistësh e diplomatësh me përvojë për t'i çuar në kryeqendrat botërore për ta kërkuar heqjen e sanksioneve e për t'i parashtruar hapat e ardhshëm të vendit. Ai ka përsëritur se LDK-ja nuk sheh rrugë bashkëpunimi për të ardhmen me qeverinë Kurti. “Po ashtu, prezantuar idenë që Kosova do të ndërtojë një ekip profesionistësh, ekspertësh të

rendit kushtetues, drejtës juridike, arsimit, kulturës e zhvillimeve ekonomike për të ndërtuar draft-statusin e ardhshëm të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, një draft-statut i ndërtuar prej njerëzve më të mirë që ka vendi me autorësi të institucioneve të Kosovës e në plotëni me Kushtetutën e Kosovës, karakterin unitor të Kosovës dhe rendin sovran të institucioneve të Kosovës. Po ashtu, kemi prezantuar edhe planin tonë për kërkesa të drejtpërdrejta mbi obligimet që Serbia duhet t'i ketë ndaj Kosovës në marrëveshjet e arritura deri më tani. Këto janë pikat që po i diskutojmë me aktorët e ndryshëm. Ka një

pajtueshmëri të plotë me pothuajse të gjithë për gjendjen alarmante që ka Kosova”, ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se Kosova duhet ta marrë autorësinë për themelimin e Asociacionit. “Kosova duhet ta marrë autorësinë mbi draftin dhe kjo ka qenë kërkesë e vazhdueshme e institucioneve ndërkombëtare. Pra, tash e një vit të gjitha institucionet ndërkombëtare, në veçanti ShBA-ja, ka kërkuar që Kosova, institucionet e vendit të marrin autorësinë, në mënyrë që kjo autorësi të mos i vihet një pale tjetër. Pra, nuk është e vërtetë se nga ne nuk pritet një gjë e tillë, përkundrazi kërkohet nga ne dhe jo vetëm kaq, Kosovës i garantohet që kjo pritie nuk ka të bëjë me rrënim kushtetues ose me dalje prej Kornizës Kushtetuese. Ne duhet të ndihemi me veten më të sigurt, por edhe duhet të shtrijmë një version të qartë se Kosova është një vend i paqes, stabilitetit, jo vetëm në vend, por sidomos në veri të vendit dhe në rajon”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka thënë se organizatat e shoqërisë civile u kanë dhënë mbështetje propozimeve të LDK-së për shtensionimin e situatës në veri. “Unë nuk shohë rrugë përpara me këtë qeveri, prandaj rruga jonë nuk ka të bëjë me bashkëpunim me këto institucione që i kanë sjellë vendit edhe tension edhe përplasje dhe nuk janë të afta të dalin prej kësaj rruge. Unë po flas për një rrugë të tretë”, është shprehur Abdixhiku.

“Remi” thotë se i ka caktuar vetë zyrtarët për informim në Zonën Operative të UÇK-së në Llap

HAGË, 11 KORRIK - Rustem Mustafa, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Zonën Operative të Llapit, në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka deklaruar se zyrtarët për informim me publikun i ka caktuar vetë.

Një deklaram të tillë dëshmitari Mustafa e ka bërë duke u përgjigjur në pyetjet e prokurores Clare Lawson. Prokurorja Lawson e ka pyetur atë nëse i kujtohet një dokument ku, sipas saj, jepen udhëzime si të vepruara me gazetarët, vëzhguesit dhe diplomatët. Në lidhje me këtë, dëshmitari Mustafa ka thënë se i kujtohet se mirësjellja me gazetarët dhe vëzhgues është diskutuar brenda radhëve të UÇK-së, por se dokumenti si dokument nuk i kujtohet. Paraprakisht, ai ka thënë se në shkëmbim të atë dokument ishte i zëdhënësist të UÇK-së, Jakup Krasniqi.

Më tutje, sipas prokurores Lawson, paragrafi dy i atij dokumenti ka të bëjë me vëzhguesit, e që ajo ka lexuar se



aty thuhet se shtabi i përgjithshëm ka caktuar personin për informim të ndërsjellët.

Mirëpo, dëshmitari Mustafa ka thënë se për Zonën Operative të Llapit zyrtarët për informim me publikun i ka zgjedhur ai, e jo Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e që, sipas tij, kanë qenë Ismet Çakiqi, Lirak Qelaj, Hysen Fazliu dhe eprorë të lartë të zonës si shefi i Shtabit, zëvendësi i tij si dhe komandantët e brigadave.

Ndërsa kur atij i është paraqitur një dokument tjetër ku thuhet se Fatmir Humolli është caktuar ndërlidhës për Zonën Operative të Llapit, dëshmitari Mustafa ka thënë se “është emri që më së paku është marrë me këtë çështje. Mund të jetë caktuar, por unë s’e paskam ditë këtë gjë”.

Ndryshe, në fillim të dëshmisë së tij, dëshmitari Mustafa ka deklaruar se në UÇK ka qenë nga ushtar deri në pozitën e komandantit të Zonës Operative

të Llapit.

Po ashtu, ka thënë se ka dhënë intervista në vitin 2002, për procesin e vitit 2003, përsëritjet më 2009 dhe 2013 dhe procesin e Apelit në vitin 2015, si dhe intervistë edhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Lidhur me intervistën në ZPS, ai ka thënë se i është dhënë mundësia t'i rishikojë deklaratat e tij, por që nuk ka pasur pse të ndërhyjë dhe të bëjë korrigjime në to. “Jo s’kam pas pse të

ndërhyj, pse të mendoj ndryshe”, ka thënë ai.

Mustafa ka thënë se beteja e parë në të cilën kishte marrë pjesë ai në Zonën Operative të Llapit ka qenë në Kaçandoll në shtator të vitit 1998, kur ka thënë se armëpushimi ka ndodhur, me sa i kujtohej, në tetor të '98-s. Rustem Mustafa, ish-komandant i UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, në cilësinë e dëshmitarit të 13 me radhë, ka dhënë betimin e tij në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), në Hagë, në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Mustafa, i njohur si “Remi” gjatë luftës, është duke dëshmuar pa masa mbrojtëse dhe leximi i deklaratës së betimit në gjykatore është bërë në seancë publike. Për dëshmitarin Mustafa është paraparë të merret në pyetje 12 orë nga prokuroria, ndërsa nga ekipet mbrojtëse 23 orë, kurse 1 orë nga mbrojtësi i viktimave. Pyetjet nga ana e prokurorisë ndaj dëshmitarit Mustafa është duke i bërë prokurorja Clare Lawson. /Betimi për Drejtësi/



NDËRKOMBËTARËT INSISTOJNË PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NATO-ja dhe ShBA-ja përsëri bëjnë thirrje për shtensionimin e situatës në veri

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleanca veriatlantike është e shqetësuar për situatën në veri të Kosovës. Ai në nisje të samitit dyditor të NATO-s në Vilnius të Lituaniës ka bërë thirrje për shtensionimin e situatës në veri. Lidhur me shtensionimin e situatës ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka folur edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Ai ka thënë se e ka vështirë ta thotë se janë afër shtensionimit të situatës. Hovenieri ka theksuar se veriu është i komplikuar dhe mënyra se si Qeveria e Kosovës është duke e menaxhuar situatën atje është shumë e ndjeshme. Në këtë kontekst, Hovenier ka thënë se ShBA-ja dëshiron që Kosova të jetë e koordinuar me aleatët ndërkombëtarë në mënyrë që të shmangen momentet e krizës që “pengojnë rrugën tonë të gjatë për të arritur këtë qëllim të përbashkët”

Lirim GECI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, para fillimit të samitit dyditor të aleancës veriatlantike, në Vilnius të Lituaniës, ka ripërsëritur shqetësimin për situatën në veri të Kosovës, e cila mbetet e tensionuar që nga 26 maji i këtij viti, kur Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për t'i instaluar kryetarët e sapozgjedhur në komunat veriore nën asistencën

e Policisë së Kosovës, pa koordinim me komunitetin ndërkombëtar. “Ne u bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta shpërshkallëzojnë situatën dhe të shmangin çdo lloj hapi që mund të kontribuojë në rritjen e tensioneve në këtë pjesë të vendit”, ka thënë Stoltenbergu. Për shkak të jostabilitetit, dhunës dhe rritjes së tensioneve, Stoltenbergu ka thënë se NATO-ja përmes misionit të vet në Kosovë, KFOR-it, ka rritur praninë e saj në Kosovë duke dislokuar trupa shtesë. “NATO

është e pranishme në Kosovë. Ne i kemi trupat e KFOR-it aty të cilët po mirëmbajnë sigurinë dhe stabilitetin për kosovarët dhe etnitë e tjera që jetojnë aty”, ka thënë ai.

Më tutje, Stoltenbergu ka thënë se është i gatshëm të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, teksa ka bërë thirrje për shtensionim të situatës në veri të Kosovës.

Presidenti Vuçiq ka thënë më 6 korrik se do të kërkojë takim me Stoltenbergun pas samitit të NATO-s në Vilnius, më pas një

seancë urgjente të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) për shkak të situatës në Kosovë. “Jam në kontakt të vazhdueshëm me (presidentin e Serbisë, Aleksandër) Vuçiqin, dhe patjetër që jam i gatshëm të takohem. Jemi të shqetësuar për rritjen e tensioneve në Kosovë dhe u bëjmë thirrje të gjitha palëve që ta shtensionojnë (situatën) dhe të përmbahen nga çdo veprim që mund ta përshkallëzojë më tej situatën në rajon”, ka thënë Stoltenbergu.

**Ambasadori amerikan:
Vështirë të them se jemi afër shtensionimit në veri**

Lidhur me situatën në veriun e Kosovës ka folur të martën edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Ai ka deklaruar se e ka të vështirë ta thotë se janë afër arritjes së një zgjidhjeje për situatën në veri përkundër takimit të zëvendëskryeministrit Besnik

Bislimi me emisarin e Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Pas pjesëmarrjes në një aktivitet në Pejë, ambasadori amerikan para gazetarëve ka theksuar nevojën edhe të zbatimit të plotë të marrëveshjes bazë. “Do të thosha që ShBA-ja mbetet e përkushtuar siç ka qenë gjithmonë që ta shohë Kosovën duke arritur qëllimet e veta. Ajo që dua të them është se ne jemi prapa një Kosove sovraane, të pavarur, multietnike dhe demokratike që zë vend në strukturat evropiane e euroatlantike. Po bëjmë punë të madhe për këtë. Kjo, po ashtu, nënkupton që Kosova ta ushtrojë sovranitetin e saj. Veriu është i komplikuar dhe i vështirë dhe mënyra se si Qeveria e Kosovës menaxhon situatën është shumë e ndjeshme dhe duam të jetë shumë e koordinuar me aleatët ndërkombëtarë që të shmangen momentet e krizës që pengojnë rrugën tonë të gjatë për të arritur këtë qëllim të përbashkët”, ka thënë ai. Më tutje, ai ka refuzuar të flasë

Gjermania pritet të vendosë masa edhe ndaj Serbisë

BERLIN, 11 KORRIK - Gjermania javën e kaluar ka rritur presionin ndaj Kosovës duke anuluar përkohësisht tre projektet e para të bashkëpunimit me Kosovën në përputhje me vendimin e marrë nga Këshilli i Bashkimit Evropian për masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Siç ka konfirmuar Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë dhe Ministria e Punëve të Jashtme në Berlin për "DW"-në, bëhet fjalë për tri projekte që ende nuk kanë nisur ende. "Janë konsultime dhe formate bashkëpunimi në fushat e bashkëpunimit të sigurisë dhe bashkëpunimit për zhvillimin", tha ministria gjermane, por shtoi se ndëshkimet nuk prekin 'projektet me sektorin e shoqërisë civile si dhe në projektet që tashmë kemi filluar t'i zbatojmë'. Të gjitha projektet e prekura mund të rifillojnë në çdo kohë. Parakusht për këtë është zbatimi i masave të nevojshme për shtensionimin e situatës në komunat veriore", është thënë në përgjigjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

"DW"-ja e ka pyetur Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë se a e ka ndërmend Berlioni zyrtar të marrë masa ndëshkuese ndaj Serbisë e cila është duke refuzuar



zbatimin e ujdisë së Ohrit. Në përgjigjen e kësaj ministrie është thënë se "ashtu si Kosova, ne presim që Serbia të kontribuojë në mënyrë aktive në shtensionimin e gjendjes". "Serbia duhet të angazhohet qartazi për zbatimin e ujdisë së Ohrit, për të cilën ra dakord në fillim të këtij viti

dhe nuk duhet të vërë më në dyshim vlefshmërinë dhe natyrën obliguese të saj. Duke pasur parasysh situatën e tensionuar - siç bëmë me Kosovën, ne po shqyrtojmë, pra, jo vetëm në kuadër të BE-së, por edhe në planin dypalësh se çfarë masash mund të ndërmerren ndaj

Serbisë, për shembull duke pezulluar projektet dhe formatet e bashkëpunimit", ka thënë Ministria e Jashtme e Gjermanisë. Deklaratat e presidentit Aleksandër Vuçiq tregojnë se si Kosova ashtu edhe Serbia aktualisht po e pengojnë në të njëjtën masë shtensionimin e

situatës, ka thënë kjo ministri. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq kishte njoftuar javën e kaluar, më 06.07.2023, se po shqyrton mundësinë që javën e ardhshme të nënshkruajë një vendim për ndalimin e eksportit të mëtejshëm të municionit nga Serbia si dhe të çdo arme.

Hoti me kritika të ashpra për qeverinë: E zëvendësuan Uashingtonin dhe Brukselin me Ohrin dhe Bratisllavën



PRISHTINË, 11 KORRIK - Emisari special i Bashkimit Evropian (BE) në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është takuar të hënën në Bratisllavë me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi. Lajçaku ka thënë se kanë rënë dakord për hapat e parë drejt shtensionimit të situatës në veri, por nuk ka dhënë shumë detaje. Lidhur me këtë ka reaguar ish-kryeministri dhe deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti.

Hoti ka thënë se askush nuk është duke e ditur se për çfarë janë marrë vesh. Me këtë rast, Hoti ka kritikuar qeverinë për raportet me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian (BE). "Duke mos përfillur këshillat e aleatëve, bien në kurthin e Vuçiqit që për qëllim ka tensionimin e situatës në veri. Kryetarët e zgjedhur me 2 për qind i fusin në zyrë me polici dhe i mbajnë të ngjuar. Nuk i

përfillin kërkesat e aleatëve kur u vijnë për vizitë në Prishtinë dhe u kërkojnë zgjedhje të reja në ato komuna pa kushte nga asnjëra palë. Shkojnë në Bratisllavë e merren vesh për shtensionim të situatës, por askush nuk di gjë se çfarë janë marrë vesh. Uashingtonin e Brukselin i kanë zëvendësuar me Ohrin e Bratisllavën. Kjo është politikë se jo mahi", ka shkruar Hoti në "Facebook".

për caktim afatesh për shtensionimin e situatës në veri, por ka thënë se e sheh me urgjencë këtë çështje. Po ashtu, Hovenieri ka thënë se ShBA-ja nuk do të flasë më shumë se ajo që ka thënë KFOR-i për rastin e tre policëve të Kosovës që janë kidnapuar nga forcat serbe. Për sanksionet e mundshme ndaj Serbisë, Hovenieri ka thënë se duhet të flasë ambasadori amerikan në Serbi ose emisari i ShBA-së për Ballkanin, Gabriel Escobar. Megjithatë, ai ka vlerësuar se "nuk është Kosova e vetmja përgjegjëse për tensionet". Sidoqoftë, ai ka thënë se ka pasur shqetësime për disa nga veprimet e qeverisë në fund të majit.

Ai ka thënë se frika e qytetarëve në veri është konkludim që qeveria të punojë për shtensionim më të shpejtë. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, të hënën ka zhvilluar një takim të paparalajmëruar me emisarin e Bashkimit Evropian (BE), Miroslav Lajçak, në Bratisllavë, ku u tha se patën "bisedime intensive". Bislimi dhe Lajçaku është thënë se janë pajtuar për hapat e parë që duhen bërë për shtensionimin e situatës në veri. "Jemi pajtuar për hapat e nevojshëm për ta siguruar shtensionim efektiv të situatës dhe të bazuar në ligj dhe për përqendrim në normalizimin dhe zbatimin e sundimit të ligjit",

ka shkruar Bislimi në "Twitter" pas takimit me Lajçakun. Ndërsa Lajçaku ka thënë se me Bislimin kanë zhvilluar "bisedime intensive", duke konfirmuar dakordimin. "Kemi biseduar për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës në përputhje me deklaratën e shteteve anëtare të BE-së më 3 qershor, por edhe për mënyrën përpara për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog. Jemi pajtuar për hapat e parë drejt arritjes së këtij qëllimi", ka shkruar Lajçaku në "Twitter". Për shkak të moshtensionimit të situatës në veri, Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur disa masa kundër Kosovës, të cilat janë kryesisht financiare.



Osmani: Dënojmë përpjekjet për mohimin e gjenocidit në Srebrenicë, po rriten tendencat për destabilizim

PRISHTINË, 11 KORRIK - Në Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se ka përsëritur dënimin e fuqishëm kundër çdo përpjekjeje për ta mohuar gjenocidin në Srebrenicë. Këto komente ajo i ka bërë në takimim me deputetin e Dhomës së Përfaqësuesve të Bosnjë-Hercegovinës, Shemsudin Mehmedoviq, dhe një delegacioni të përfaqësuesve të komunitetit boshnjak në Kosovë, përfshirë zëvendëskryeministren Emilija Rexhepi dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sipas një njoftimi për medie të Precedencës, në takimim që është zhvilluar të martën, Osmani citohet të ketë thënë se koordinimi i përbashkët është tejet i rëndësishëm në këtë periudhë kur, sipas saj, "tendencat për destabilizim dhe minim të paqes janë në rritje".



"Prandaj në këtë drejtim ka vlerësuar edhe kontributin e jashtëzakonshëm të komunitetit boshnjak në Kosovë si urë ndërlidhëse e këtij koordinimi.

Gjatë takimit deputeti Mehmedoviq falënderoi presidenten Osmani për përkrahjen e vazhdueshme si dhe për rolin e saj në miratimin e

Rezolutës së Kuvendit të Republikës për gjenocidin në Srebrenicë", është thënë në njoftim. Osmani është thënë se ka

potencuar se "vuajtjet e popullit boshnjak në këtë ditë të trishtë ndahen edhe nga populli i Kosovës, duke theksuar se gjenocidi në Srebrenicë është simbol i tmerrit të krimeve gjenocidale serbe".

"Presidentja ka thënë se kujtimi për ta është i çdoditshëm, ndërsa ka folur edhe për krimet makabre dhe masakrat e regjimit gjenocidal serb kundër popullit të Kosovës. Presidentja ka përsëritur dënimin e fuqishëm kundër çdo përpjekjeje për ta mohuar gjenocidin e Srebrenicës, sepse ky mohim ka për qëllim denigrimin e viktimave dhe fshehjen e motiveve të krimeve të kryera", është thënë në njoftim.

Viktimat e gjenocidit në Srebrenicë janë përkujtuar edhe nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ai i Shqipërisë, Edi Rama, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj etj.

Spitali i Vushtrrisë do të zgjerohet, komuna e jep në shfrytëzim ish-objektin e QKMF-së

VUSHTRRI, 11 KORRIK - Pas vizitës së përbashkët në spitalin "Sheikh Zayed" të Vushtrrisë, kryetari i kësaj komune, Ferit Idrizi dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kanë bërë me dije se kapacitetet e këtij spitali do të zgjerohen.

Idrizi ka thënë se me kërkesën e këtij spitali dhe të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), ish-objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në këtë komunë do t'i jepet në shfrytëzim spitalit për ta zgjeruar infrastrukturën dhe shërbimet e ofruara për qytetarët. Ai ka thënë se këtë çështje do ta procedojnë në Komunitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal të Komunës ku, sipas tij, do ta ketë një mbështetje të fuqishme.

I pari i Vushtrrisë ka thënë se qëllimi kryesor i vizitës ishte që ministri Vitia t'i shihet nga afër shërbimet shëndetësore, primare dhe sekondare në Vushtri. "Dua ta falënderoj ministrin Vitia që vizitoi komunën e Vushtrrisë. Patëm një takim jashtëzakonisht të frytshëm dhe tani bashkë me të jemi këtu në spitalin 'Sheikh Zayed' për një vizitë. Qëllimi i vizitës është për ta parë gjendjen



nga afër ministri për komunën e Vushtrrisë, shërbimet shëndetësore, primare dhe sekondare. Biseduam rreth ish-objektit të Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), kërkesë që e ka bërë spitali dhe ShSKUK-ja për ta dhënë në

shfrytëzim për ta zgjeruar infrastrukturën në spitalin e Vushtrrisë. Ne shprehëm gatishmërinë që këtë ta procedojmë në Komunitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë në këtë seancë. Do t'i

japim një mbështetje të fuqishme në mënyrë që spitali t'i zgjerojë kapacitetet dhe të ofrojë shërbime edhe më të mira", ka thënë Idrizi. Edhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, është shprehur se kishte një takim të frytshëm

dhe miqësor me kryetarin Idrizi. Ai është ndarë i kënaqur nga gatishmëria e kryetarit Idrizi që t'i përgjigjet pozitivisht kërkesës së spitalit "Sheikh Zayed" për zgjerimin e kapaciteteve të këtij spitali në një pronë e cila është komunale. Ai ka thënë se rezultatet e këtyre takimeve do të përkthehen në shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Vushtrrisë. "Jemi shumë të sigurt se me zgjerimin e këtyre hapësirave do të shtohen shërbimet në këtë spital për qytetarët e Vushtrrisë, por natyrisht se do të rritet edhe cilësia e këtyre shërbimeve. Nga këto takime ne kuptuam se nuk ka asnjë arsye që kjo të mos bëhet dhe jam i lumtur që po dal nga ky takim me një energji shumë të mirë, pozitive, mbi të gjitha me rezultatet e këtyre takimeve që do të përkthehen në shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Vushtrrisë" ka thënë Vitia.

Ndërsa drejtoresha e spitalit "Sheikh Zayed", Shefikje Shatri, e ka falënderuar ministrin Vitia dhe kryetarin Idrizi për mbështetjen e dhënë për këtë spital.

Komisioni i rekomandon Kuvendit shkarkimin e Bordit të KPMM-së

Prishtinë, 11 korrik - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, me 6 vota për i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës shkarkimin e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Komisioni ka rekomanduar shkarkimin e kryesueses së

Bordit të KPMM-së, Selvete Grajqevci - Pllana dhe të anëtarëve Gani Maliqi, Gani Kastrati dhe Rozeta Pushkolli-Makolli.

Ndërsa një ditë më parë anëtari i pestë i Bordit të KPMM-së, Jahir Gashi, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë.

Fillimisht kryetari i Komisionit

Parlamentar për Ekonomi, Ferat Shala, ka kërkuar nga anëtarët e këtij komisioni ta tërheqin kërkesën për shkarkimin e Bordit të KPMM-së. Për shkarkimin e bordit të KPMM-së kanë votuar deputetët Mimoza Kusari - Lila, Jeta Statovci, Amend Muja, Gramos Agusholli, Fidan Jilta dhe Driton Hyseni.



Çitaku: Hashim Thaçi disa i tremb edhe nga burgu!



PRISHTINË, 11 KORRIK - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se eksponentë të partisë në pushtet janë duke u munduar t'ia bëjnë gjyqin publik ish-kryeministrit të Kosovës,

Hashim Thaçit, edhe nga burgu.

Në "Facebook" Çitaku ka shkruar se Thaçi e ka bërë luftën për liri, ndërsa me Kushtetutë u ka ofruar siguri komuniteteve pakicë. Çitaku këto deklarime i ka bërë pas

publikimit të një videoje nga Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën ajo i ka akuzuar ish-qeveritarët, përfshirë edhe ish-kryeministrin Hashim Thaçi, për bashkëpunim me Serbinë. "Hashim Thaçi është në burg. Duke u përballur me betejën e

tij të fundit në mbrojtje të luftës tonë për liri. Hashim Thaçi, përveç që ka pasur guxim me i hy luftës për liri, ka pasur guxim edhe me ndërtuar paqe. Me ofruar e garantuar të drejta për komunitetet jo shumicë. E ka bërë atë me Kushtetutë.

Hashim Thaçi disa i tremb edhe nga burgu. Andaj mundohen t'ia bëjnë gjegjin publik edhe këtu, në një kohë kur ai nuk mund të përgjigjet. E di, ju dhemb. Ai është gjithçka që ju ëndërroni, po nuk jeni. Të mjerë", ka shkruar Çitaku.

AAK-ja mbledh drejtuesit e sindikatave, ata ankohen për qasjen e qeverisë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka mbajtur tryezën e organizuar si vazhdimësi e dialogut social. Në këtë tryezë kanë marrë pjesë përfaqësues të sindikatave në vend, të cilët i kanë paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i AAK-së, ka thënë se qëllimi i kësaj tryeze ka qenë diskutimi në lidhje me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik, Projektligjin për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Skemat Sociale të financuara nga shteti dhe çështje të tjera që ndërliidhen me skemat sociale. Ai të pranishmëve ua ka paraqitur edhe iniciativën që kanë marrë si grup parlamentar, duke shtuar se koeficienti në Ligjin e Pagave duhet të jetë 129 euro me një amendament të veçantë. "Po vazhdon dialogu social me sindikata. Po flasim për Ligjin e Pagave. Po ashtu, për Ligjin për Pensione. Është e pafalshme kur ekziston ligji të mos mund të formësohet paga. Ne kemi



biseduar me kryetarin Haradinaj dhe e kemi marrë një iniciativë. Mendojmë se mënyra e vetme për t'i dhënë zgjidhje është koeficienti 129 euro. Ky koeficient mund të bëhet me një amendament në Kuvend", ka thënë Tahiri.

Ndërsa ish-ministri i Financave, Haki Shatri, ka bërë një analizë më të hollësishme lidhur me pagat. "Si grup parlamentar jemi duke analizuar si t'i qasemi kësaj teme. I takon Aleancës dhe

neve të bëjmë një nismë të tillë tani. Detyrimisht, qeveria duhet ta miratojë sepse e ka miratuar një nismë të gjashtë deputetëve të LV-së. Aleanca ka marrë vendim që ta bojkotojë vendimin dhe nëse qeveria reflekton, edhe Aleanca do të reflektojë. Kjo lidhet jo vetëm me një kauzë tonën, por me të drejtën e juve (sindikatave)", ka thënë ai. Ndërsa deputeti i AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka kërkuar përkrahjen e të gjithëve që

nismat e tyre të shkojnë përpara. "Mospagesa në ndërlukeshmëri në nivele të ndryshme të shërbimeve janë ato me të cilat si Aleancë po merremi. Do të ishte mirë që të reflektojmë. Besniku ka lobuar në Kuvend që kjo iniciativë të ketë një përmblyllje të mirë. Kërkojmë përkrahjen tuaj si medie dhe si publik që të sensibilizohet opinioni. Ne punojmë për ju. Ne jemi me ju dhe për ju, pavarësisht a jemi pozitivë apo opozitivë", ka thënë Dreshaj.

Më tutje, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka shprehur pakënaqësitë e tij ndaj qasjes së ministrit të Financave, Hekuran Murati dhe qeverisë Kurti. "Në situatën kur qeveria Kurti ka qasje të gabuar ndaj sindikatave, kur ministri Murati po harron se pos ministër i Financave është edhe i Punës, ju përgëzoj edhe juve z. Tahiri dhe profesorin e nderuar për iniciativën. Ata po garojnë se kush po del më inatçi me sindikatat se tjetri. Ne kemi vlerësuar se qeveria ka qenë faktor në publik që

ligjin ta dështojë. Nuk kemi shkuar tek Avokati i Popullit dhe gjykatat duke shpresuar se do të dalin deputetë të flasin për këtë gjë. Një numër i kolegëve të mi po kërkojnë pushim pa pagesë në mënyrë që të dalin dhe të mos kthehen më në Kosovë. Më e keqe se greva është greva e heshtur. Greva e heshtur është kur shkojnë në punë punëtorët pa vullnetin e duhur. Edhe në sistemin arsimor kemi grevë të heshtur dhe Qeveria e Kosovës duhet bërë një pyetje vetes, edhe pse i ka sharë mësimdhënësit: kush do t'i mësojë fëmijët kur mësimdhënësit të mos jenë më këtu? Ata mund t'i kenë miliardat për të marrë mësimdhënësit nga jashtë, por fëmijët mësojnë në shqip", ka thënë Jasharaj.

Kurse kryesindikalisti i Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri, ka thënë se nuk janë të interesuar ta luajnë rolin e opozitës për ta rrëzuar qeverinë, por po duan t'i përmbushen kërkesat e tyre. Ai ka thënë se Policia e Kosovës është më e vjetra në rajon.

Hajdari: Zonat ekonomike s'kanë qenë tërheqëse për investitorë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se pajtohet me të gjeturat e auditimit të performancës "Mbështetje e ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme MINT/KIESA". Njërin nga shqetësimet që ka ngritur auditori, Hajdari tha se është mungesa e furnizimit me ujë dhe hapja e puseve për nevoja të bizneseve të Parku i Biznesit në Drenas. Sipas

saj, Kosova nuk ka arritur ta zbërthejë potencialin ekonomik privat. Madje ajo ka thënë se zonat ekonomike nuk kanë sjellë vlerë të shtuar, por nuk kanë qenë tërheqëse për investitorë. "Në vitin 2021 dhe 2022 kemi kërkuar këtë auditim të performancës sepse nuk kishim politika të mirëfillta për sektorin privat. Kosova nuk ka arritur ta zbërthejë potencialin ekonomik privat. Kemi zhvilluar

strategjinë kombëtare për biznese deri në vitin 2030 bazuar në këto gjetje të auditimit të performancës. Synojmë transformim të industrisë sonë. Sa iu përket zonave ekonomike, kemi marrë raportin e performancës dhe nuk kanë sjellë vlerë të shtuar dhe nuk kanë qenë tërheqëse për investitorë", ka thënë Hajdari në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.



Hovenieri: ShBA-ja është e përkushtuar që të rinjtë të gjejnë punë në Kosovë



PEJË, 11 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka marrë pjesë të martën në ceremoninë e hapjes zyrtare të qendrës më të re "Bonevet" në Pejë. Hovenieri ka thënë se ShBA-ja është e përkushtuar që të rinjtë e Kosovës të gjejnë punë në vendin e tyre. "Bonevet" u ofron të rinjve nga Peja mundësi arsimit në fusha të ndryshme. E kam parë ndikimin direkt të 'Bonevet' në jetën e shumë të rinjve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përkushtuara ta mbështetin Kosovën e kjo përfshin edhe

mbështetjen për të rinjtë që të gjejnë punë pikërisht në Kosovë. Shpresojmë se të rinjtë e talentuar të Kosovës të arrijnë t'i përdorin shkathtësitë e fituara këtu", ka thënë Hovenieri.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri. "Bonevet" është organizatë multidisiplinare, e cila merret me zhvillimin, aftësimin dhe praktikën e njohurive të ndryshme arsimore dhe teknologjike për fëmijë dhe të rritur. Deri më tani kjo organizatë ka pasur degë në Prishtinë e Mitrovicë./RTK

ZKA-ja konfirmon se 149 persona të 'Mbrojtjes Civile' kanë marrë paga pa qenë në marrëdhënie pune

Prishtinë, 11 korrik - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka thënë se janë identifikuar 149 persona të Mbrojtjes Civile të cilët kanë marrë paga përkundër që nuk janë në marrëdhënie pune. Lajmin e ka konfirmuar auditorja e përgjithshme e ZKA-së, Vlora Spanca, duke bërë me dije se vlera e pagesës është mbi 700 euro në vit. "Kemi potencuar një çështje e cila e përcjell Qeverinë e Kosovës, është ajo e pagesave për punonjësit që nuk e vijnë punën. Ky është rezultat i Marrëveshjes së Brukselit dhe një vendim i qeverisë që është nënshkruar në vitin 2015 për integrimin e ish-Mbrojtjes Civile në institucionet publike. Numri i tyre është 149 dhe vlera është mbi 700 mijë euro në vit", ka

thënë Spanca për "Telegrafin". Sipas saj, tashmë këto pagesa janë ndaluar. "Mund të them se këtu ka përmirësime në këtë aspekt. Ministria e Arsimit dhe ajo e Ekonomisë e kanë zgjedhur këtë problem, duke iu ofruar kushte dhe punonjësit kanë filluar të punojnë, përderisa Ministria e Kulturës me marrjen e raportit, në qershor apo në korrik të vitit të kaluar, ka ndaluar pagesat", ka shtuar ajo.

Dy javë më parë Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim t'i shpallë terroriste organizatat serbe "Mbrojtja Civile" dhe "Brigada e Veriut", të cilat operojnë në pjesën veriore të vendit. Këto dy organizata dyshohet se janë përgjegjëse për shumë krime të kryera në veriun e Kosovës. Pikërisht për



këto dyshohet të ketë qenë i destinuar arsenali i armëve i cili u kap para pak ditësh në një veturë në Zveçan. "Mbrojtja Civile" në Serbi funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shpallja e tyre si organizata terroriste vjen në kohën kur tensionet në veri të Kosovës - të banuar me shumicë serbe - janë rritur. Serbët lokalë janë duke kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit që janë zgjedhur më 23 prill. Këto zgjedhje janë bojkotuar nga serbët. Që nga 26 maji serbët kanë protestuar në veri dhe që atëherë në këtë zonë janë regjistruar disa sulme me shok-bomba dhe granata dore, që kanë shkakuar dëme materiale, por pa pasoja në njerëz.

Ministria e Bujqësisë fillon realizimin e pagesave të subvencioneve për fermerët

Prishtinë, 11 korrik (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka bërë me dije se janë proceduar dy milionë euro pagesa për fermerët në kuadër të Programit të Pagesave Direkte 2023. Sipas

ministrit të MBPZHR-së, Faton Peci, pagesat do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim. "Kemi filluar realizimin e pagesave të subvencioneve. Sot kemi proceduar dy milionë euro për pagesë për Programin e Pagesave

Direkte/ Subvencioneve 2023 për sipërfaqe pas kontrolleve rigorozë në terren. Me këtë intensitet të pagesave do të vazhdohet edhe në ditët në vijim, ndërsa pagesat për plehërimin dhe naftën do të procesohen/paguhen pasi që

fermerët t'i sjellin faturat si dëshmi. Ju rikujtojmë se për herë të parë kontrolla në shumë komuna të Kosovës nga 5 për qind apo 10 për qind është rritur në 100 për qind", ka shkruar Peci në "Facebook".



Pse debatet janë budallallëk dhe të rrezikshëm, sipas PLATONIT



Ka një ndryshim midis dialektikës dhe debatit. Kur takoni dikë me një pikëpamje të ndryshme nga e juaja, me siguri do t'i riktheheni debatit. Por debati është një lloj sporti, me fitues dhe me humbës. Debatet nuk kanë të bëjnë me afrimin me të vërtetën, por për atë se kush del më i miri. Në Greqinë e Platonit, sofistët ishin debatues profesionistë. Sot, ne mund të mësojmë truket e tyre për të kuptuar debatet e tyre të zbrazëta.

Pak njerëzve u bëhet vërtet vonë për të vërtetën. Mund të themi se po, por kur bëhet fjalë për këtë, njerëzit janë të gjithë shumë të ndjeshëm ndaj asaj dobësie shekullore: vanitetit.

Le të supozojmë se jeni duke pirë diçka me disa miq dhe po bëni një debat miqësor për një temë të diskutueshme. Ju keni mendimin tuaj, keni argumentet tuaja dhe jeni kundër dikujt tjetër. Supozoni, tani, se ata japin një kundërshebull brilant dhe e shpërbëjnë plotësisht pozicionin tuaj. Si reagoni? A thoni, "Mirë, mund të kesh të drejtë", apo dyfishoni përpjekjet tuaja? Për Platonin, është me të vërtetë një person i rrallë ai të cilit i bëhet vonë për të vërtetën. Shumica e njerëzve duan vetëm të fitojnë. Ekziston një dallim filozofik midis dialektikës dhe debatit. Dialektika është ajo ku dy njerëz me pikëpamje të kundërta diskutojnë se cili pozicion është më i miri. Shqetësimi i tyre është

se çfarë është e drejtë, dhe një dialektikë zakonisht zgjidhet me një lloj kompromisi ose sinergie që është një përmirësim i secilit pozicion. Debati, nga ana tjetër, është një lloj sporti. Dhe, si me shumicën e sporteve, duhet të ketë një fitues dhe humbës. Ashtu si sportet e tjera, ju mund të stërviteni për t'u bërë më të mirë në debat. Ju mund të mësoni truket për ta bërë kundërshtarit të duket budalla ose argumentet e tyre duken të dobëta.

Kjo është pikërisht arsyeja pse Platon mendonte që ishin gjëra shumë budallaqe e të rrezikshme.

Sofizmi dhe vaniteti

Nëse e quani dikë sofist, jeni duke e quajtur sharlatan. Një sofist është dikush që flet mirë, mund të ngrrejë peshë një turmë dhe mund të bëjë të mençurin në kurrizin tuaj, por nuk i bëhet aspak vonë për të vërtetën. Nëse e quani një politikan sofist, po thoni se atij i intereson vetëm marrja e votës dhe nuk ka ndonjë parim. Dhe arsyeja pse "sofist" është bërë një term kaq poshtërues, është e gjitha për shkak të Platonit.

Në Greqinë e Platonit, sofistët ishin filozofë, por ata ishin më të merakosur për artin e retorikës dhe të bindjes. Ishin të fokusuar tek debati dhe jo tek dialektika. Sofistët ndonjëherë bënin shumë para duke u mësuar të tjerëve artin e madh për të fituar një debat. Ata u mësonin politikanëve aspirantë, fëmijëve

nga familje fisnike ose kujtdo me një qese mjaft të madhe parash, se si ta bëni kundërshtarit të dukej budalla. Ata mësonin se si ta bënin turmën në anën e tyre, dhe u mësonin se si të dukeshin të sigurt ndërsa e bënin atë gjë.

Platon argumentonte, pra, se sofistët (dhe arti i debatit në përgjithësi) merrshin vetëm me opinionin popullor. Ata thoshin atë që e dinin se do ta bënte të lumtur turmën dhe "parimet" e tyre gjithmonë përputheshin me cilindo që po i dëgjonte. Ata hidheshin ngado që të frynte era. Për sofistët, e drejta dhe e gabuara nuk kishin aq rëndësi sa brohoritja apo e qeshura.

Fuqitë eristike

Sofistët nuk janë vetëm mjeshtra të retorikës (të folurit bindës), por edhe të eristizmit. Eristizmi është gatishmëria që një person ka për të përdorur çfarëdo trukesh që mundet, për të fituar një debat. Siç thotë filozofi Xhon Gilbert, "Folësi [] eristik shfrytëzon paqartësitë dhe gabimet dhe është i gatshëm të endet në një paqartësi të pafund, nëse beson se do t'i shërbejë kauzës së tij." Me pak fjalë, eristik do të thotë ta trajtohet debatin si një sport, dhe jo një endje filozofike. Ja tre shembuj të eristikës:

Përdorimi i dilemave të rreme. Një debatues i mirë do të përpiqet të "godasë" një kundërshtar duke përcaktuar gamën e pozicioneve të

pranueshme. Për ta bërë këtë, ata shpesh paraqesin dy ose disa opsione si opsionet e vetme. Për shembull, në një debat mbi ndryshimin e klimës, një sofist mund të pretendojë: "Ne duhet të ndalojmë të gjitha aktivitetet industriale tani ose të përballemi me një lloj shfarosje". Kjo eliminon një spektër të tërë nuancash dhe masash lehtësuese.

Sulmet ad hominem. Ndonjëherë, sulmi ndaj një personi në të vërtetë mund të justifikohet filozofikisht, por shpesh përdoret për të shpërqendruar ose për të poshtëruar argumentet e një kundërshtari. Më shpesh, përdoret për të shkaktuar të qeshura bajate. Për shembull, në një debat rreth politikës ekonomike, ai mund të thotë: "Nuk do të pranoja këshilla ekonomike nga dikush që blen kostumin në Walmart".

Drejtimi i gabuar. Ky është një prej kohësh i preferuari i politikanit të rrëshqitshëm. Kur bëhet një pyetje e sikletshme ose ballafaqohet me një argument të mirë, sofisti do t'i përgjigjet një pyetjeje të lidhur me të ose krejtësisht të ndryshme. Le të themi se një politikan pyetet për një rënie të rezultateve shkollore. Drejtimi i gabuar eristik do të ishte: "Ne kemi investuar më shumë se kushdo tjetër në shkollë dhe kemi punësuar 30% më shumë mësues." Kjo nuk ndihmon aspak për të trajtuar


problemin e rënies së rezultateve shkollore.

Nata e debatit

Çështja e sofizmave ka marrë një rëndësi të re në një epokë të mediave sociale, videove në internet dhe podkasteve. Për shembull, në qershor të këtij viti, Joe Rogan i ofroi 100,000 dollarë mjekut dhe shkencëtarit të vaksinave, Peter Hotez, nëse ai do të shfaqej në podkastin e tij për të debatuar me mohuesin e famshëm të vaksinës, Robert F. Kennedy Jr. Hotez, e refuzoi ofertën dhe rjetet sociale morën kot. Hotez ishte një frikacak, një mashtrues ose i pasigurt për argumentet e tij. Megjithatë, ajo që ka më shumë gjasa është që Hotez njeh këshillat e Platonit.

Kur organizoni një podcast me dhjetë milionë dëgjues, ka të ngjarë të mos merakoseni për argumentet më të mira ose për të dalluar të vërtetën. Ju doni veç argëtimin. Robert F. Kennedy Jr. është një sofist i talentuar dhe me përvojë. Ai kurrë nuk do të gabojë dhe nuk do të humbasë kurrë, sepse i di të gjitha truket eristikës. Ai mund të rrëmbejë, devijojë dhe rrëshqasë përpara gjithë shkencës dhe fakteve që mund të paraqesë Hotez. Ai do të notojë në një pishinë të madhe sulmesh ad hominem, me dilema të rreme dhe drejtime të gabuara. Dhe shumica e dëgjuesve nuk do të jenë më të mençurit. Pak njerëzve në fakt u bëhet vonë për të vërtetën; ata duan spektaklin. / big think – bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Gliha pas takimit me Ademin: Do t'ia rikthejë rezultate pozitive Kosovës

Përzgjedhësi i ri i Kosovës, Primozh Gliha në takim me kreun e FFK-së, Agim Ademi ka premtuar se do të punojë më të gjithë kapacitetin e tij që “dardanët” t'i rikthen rezultateve pozitive. Përzgjedhësi Glihasë shpejti pritet të takohet edhe me pjesën tjetër të shtabit teknik, tifozët “dardanët” dhe kapitenin Amir Rrahmani



“Epoka e re”

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi të martën e ka pritur në takim tashmë të emëruarin përzgjedhës të Përfaqësues së Kosovës, Primozh Gliha. Ademi dhe Gliha diskutuan për vazhdimin e rrugëtimit të Kosovës në kualifikimet e Kampionatit Evropian 2024. Paraprakisht, Gliha do të jetë i pranishëm në ndeshjet e ekipeve të Superligës për garat evropiane, e gjithashtu do të vizitojë edhe Kampin Nacional, atje ku përfaqësueset zinxhirë të Kosovës po zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe bashkërisht me ekipin e trajnerëve në përbërje të

Afrim Tovërlanit, Arbnor Morinës, Ahmet Beselicës dhe Thomas Richards do të analizojnë me kujdes situatën në të cilën ndodhet Përfaqësuesja e Kosovës dhe do të shqyrtojnë mundësitë për të arritur objektivat e FFK-së. “Kryetari Ademi kërkoi nga përbërja e re udhëheqëse e ekipit përfaqësues që të jenë sa më të përpiktë dhe të veprojnë konform normativave të FFK-së për ekipin përfaqësues. Gliha premtoi se do të punojë me shumë përkushtim dhe me të gjithë kapacitetin që ka ekipi përfaqësues për ta kthyer Kosovën në rrugën e fitores dhe për të arritur rezultate sa më pozitive. Ndonëse është shumë e vështirë arritja e objektivit, sipas Glihas, rrugëtimi ende

nuk ka përfunduar. Ai e konsideroi përparësi angazhimin disave në pozicione të ndryshme në futbollin e Kosovës, teksa e vlerësoi përzgjedhjen e ndihmësve të tij. Gliha njëherësh ka kërkuar nga të gjithë futbollistët që ta respektojnë maksimalisht fanellën e Përfaqësues së Kosovës dhe ta japin maksimumin”, thuhet në njoftimin e FFK-së. Në ditët në vazhdim përzgjedhësi Gliha do të takojë ekipin e tij për të kërkuar nga afër përkrahjen, kapitenin Amir Rrahmani dhe futbollistët tjerë në vendet ku ata jetojnë dhe veprojnë, e po ashtu do të takojë edhe tifozët “Dardanët” për t'i njoftuar me vazhdimin e projektit për Kosovën në Evropian dhe për të kërkuar përkrahjen e tyre.

SHKURT

FC Prishtina 01 mëson kundërshtarët në Ligën e Kampionëve

Kampioni i Kosovës në futsall, FC Prishtina 01, ka mësuar kundërshtarët e grupit në Ligën e Kampionëve. Të martën është hedhur shorti për grupet në raundet preliminare në Ligën e Kampionëve në futsall. I pranishëm ishte presidenti i klubit, Bledion Bryma. Prishtina 01 është shortuar në Grupin D, ku si kundërshtar do t'i ketë KSC Lubawa (Poloni), Utleira Idrettslag (Norvegji) dhe Isbjorninn (Islandë). Ndeshjet e këtij raundi parakualifikues do të zhvillohen nga data 22 deri në 27 gusht në Poloni. Vendi i parë i grupeve do t'u bashkohet ekipeve të tjera me koeficient më të lartë në “main-raund” me ndeshjet që zhvillohen nga 24 deri në 29 tetor.

Majlinda Kelmendi, pjesë e kampionatit stërvitor në Zagreb

Majlinda Kelmendi do të marrë pjesë në “Zagreb Grand Prix Judo Kamp 2023” që do të mbahet në Zagreb të Kroacisë. Federata e Xhudos e Kroacisë do të organizojë kamp stërvitor në Zagreb për gjeneratat U10, U12, U14 dhe U16. Ky kamp do të mbahet nga data 18 deri më 20 gusht. Federata e Xhudos e Kosovës ka bërë me dije se pjesë e këtij kampi do të jetë kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi në cilësinë e trajneres.

Feronikeli 1974 transferon Shillovën dhe Razackun

Skuadra e Feronikelit 1974 ka zyrtarizuar transferimin e dyshes sulmuese, Alban Shillova dhe Bachare Razack. “Industrialistët” kanë vazhduar përforcimet para nisjes së sezonit të ri, pas inkuadrimit në Superligën e Kosovës. Drenicasit para disa ditësh njoftuan 13 transferime, ndërsa sot (e martë) njoftuan edhe dy prurje të reja. Bëhet fjalë për dyshen sulmuese Alban Shillova dhe Bachare Razack nga Burkina Faso. Ishte vetë presidenti i Feronikelit 74, Erlind Krasniqi, i cili njoftoi transferimet e tyre me anë të një postimi në “Facebook”. Shillova është emër i njohur në futbollin e Kosovës, pasi ka luajtur për klube si Flamurtari, Llapi, Prishtina, së fundmi Malisheva. Në anën tjetër, Bachare ka bërë karrierë kryesisht në Ligën e Parë, ku ka luajtur me 2 Korrikun dhe Flamurtarin.

Ballkani mposhti Ludogoretsin, afër kalimit në raundin tjetër

Kampionia e Kosovës, Ballkani ka shënuar fitore të madhe ndaj Ludogoretsin, me rezultat 2-0, në kuadër të rrethit të parë të kualifikimeve të Ligës së Kampionëve. Golin e parë në ndeshje e shënoi Meriton Korenica,

në minutat shtesë të pjesës së parë. Në pjesën e dytë, Ballkani e realizoi edhe një gol me anë të Qëndrim Zybës, pas një harkimi brilant të Lorenc Trashit. Kampioni i Kosovës deri në fund e menaxhoi këtë

rezultat, madje duke krijuar edhe disa raste të tjera, por në fund takimi u mbyll me këtë rezultat. Skuadra suharekase ndeshjen kthye do ta zhvillojë në Bullgari në javën e ardhshme, me epërsi prej dy golave.



UEFA e fut Genc Nuza në listën e gjyqtarëve premtues për 2023/24

Prishtinë, 11 korrik - Futboli i Kosovës shënon një tjetër arritje në sektorin e ndarjes së drejtësisë. Është gjyqtari Genc Nuza i cili është përfshirë nga UEFA në programin "Mentor&Talent" për edicionin 2023/2024. Një nga gjyqtarët më të dalluar në vitet e fundit në Kosovë, i cili me sukses

ka ndarë drejtësinë edhe në ndeshjet ndërkombëtare, ka hyrë në programin e 20 gjyqtarëve më premtues të UEFA-së. Ai do ta ketë mentor ish-gjyqtarin e njohur të FIFA-s, belgun Frank De Bleckere. Ky program do të fillojë më 29 gusht. Nuza është shprehur i nderuar për

përfshirjen në këtë program, veçmas për faktin se për mentor do ta ketë një ish-gjyqtar me repute botërore. "Jam tejet i lumtur që jam i zgjedhur nga UEFA si gjyqtar premtues për të ardhmen dhe që do ta kem një mentor siç është Franck De Bleckere, i cili ka qenë gjyqtar në

kampionate botërore dhe evropiane. Shpresoj ta ngriti nivelin e referimit tim edhe më shumë gjatë këtij programi me ndihmën e mentorit tim", ka thënë Nuza, i cili ndodhet në Maltë, ku po ndan drejtësinë në Kampionatin Evropian për grupmoshën U19.



Kosova fillon përgatitjet për miqësoret kundër Lihtenshtajnit

PRISHTINË, 11 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave i ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet miqësore kundër Lihtenshtajnit që do të zhvillohen më 13 korrik, përkatësisht më 16 korrik. Këto dy ndeshje do t'i shërbejnë përzgjedhësës Anneli Andersen si test përfundimtar para nisjes së edicionit promovues të Ligës së Kombeve në shtator. "Është ndjenjë shumë e mirë të jemi sërish këtu. Jam e lumtur që i kam takuar lojtaret. Është gjithmonë mirë t'i fillosh përgatitjet në Kosovë. Ky grumbullim është paksa më sfidues, ngaqë disa lojtare kanë pasur pushime disajavore e disa lojtare kanë luajtur edhe në fundjavën që e lamë pas. Gjithsesi, ne duhet t'i mbledhim forcat dhe të përballemi me Lihtenshtajnin. Duhet të fokusohemi që pas çdo stërvitje dhe pas çdo ndeshje të jemi më të mira. Kemi një kundërshtar që nuk dimë asgjë për të dhe kjo është një sfidë e re,



por njëherësh për vajzat është një përvojë e re të luajnë me ekipe të ndryshme. Sa herë që hyjmë në fushë e kemi qëllim të luajmë mirë dhe të fitojmë. Këto ndeshje na shërbejnë që të përmirësohemi në mbrojtje dhe

sulm dhe mendoj se kemi gjasë të mira për fitore", ka theksuar përzgjedhësja Andersen. Optimizëm për paraqitje të mira në këto dy miqësore kanë shprehur edhe dy lojtaret Viola Avduli dhe Donjeta Halilaj.

Verstappen: Mund t'i fitoj i vetëm të dy titujt kampionë

Milton Keynes, 11 korrik - Skuadra Red Bull po dominon në sezonin 2023 të Formulës 1, duke i fituar të gjitha garat e zhvilluara deri më tani. Nga dhjetë gara të zhvilluara deri më tani (është anuluar ajo e Emilia Romagna), tetë janë fituar nga Max Verstappen dhe dy nga Sergio Perez. Gjithsesi, meksikani ka humbur busullën në garat e fundit, duke zhgënjyer si në provat zyrtare ashtu dhe në garë. Kjo ka vënë në dyshim qëndrimin e tij te Red Bulli, ku mund të rikthehet veterani Daniel Ricciardo. Ai që turbullon edhe më shumë ujërat është Verstappen, që u shpreh: "Nuk e kuptoj paraqitjen e Sergio's në provat zyrtare, pasi po eliminohet shumë shpejt. Me këtë makinë duhet të jetë në sesionin e tretë. Nuk e di se çfarë nuk shkon me



të". Pas fitoreve në gjashtë garat e fundit, Verstappen ka 99 pikë avantazh në renditjen e përgjithshme ndaj Perezit, ndaj të cilit hedh disa kunjë. "Ne po

luftojmë edhe për fitoren e titullit kampion për skuadra, por duke parë situatën aktuale, mendoj se mund t'ia dal edhe vetë t'i fitoj të dy titujt", ka shtuar holandezi.

SHKURT

Ajeti bëhet bashkëlojtar me Ermal Krasniqin te CFR Cluj

Klubi rumun CFR Cluj ka njoftuar zyrtarisht transferimin e mbrojtësit shqiptar Arlind Ajeti i cili vjen nga Perdonone si lojtar i lirë. "Me kënaqësi ju njoftojmë se Arlind Ajeti është lojtari i ri i ekipit tonë!", thuhet në njoftimin e klubit rumun. Qendërmbrojtësi me origjinë shqiptare, i lindur në Zvicër, ka luajtur në Serinë A për Torinon, Frosinonon dhe Crotone, ndërsa gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe në Zvicër për Grassoperin dhe FC Baselin, skuadër me të cilën ka fituar katër herë titullin dhe ka luajtur ndeshje në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Ajeti, gjithashtu, ka luajtur me kombëtaren e Shqipërisë, duke zhvilluar 21 ndeshje dhe duke qenë pjesëmarrës në "Euro 2016".

Kroos: Nuk prisja të arrija kaq shumë te Real

Në një intervistë të gjatë dhënë për "El Pais", mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, ka folur për karrierën e tij në fanellën e "Los Blancos", me të cilën fitoi gjithçka. "Kur mbërrita te Real Madridi mendova: Të shpresojmë të fitojmë diçka, ndoshta një Ligë të Kampionëve. Vija nga një gjigant si Bayerni, kisha idenë sesi të luaja për shumë vite, ta gjeja vendin tim, ta tregoja cilësinë time dhe të kisha një marrëdhënie të mirë me klubin. Prisja shumë, por jo kaq", ka thënë Kroos. "Përmbysjet historike? Të gjitha rikthimet kanë të bëjnë me psikologjinë. Pasi e keni bërë diçka të tillë shumë herë, besimi rritet dhe ekipi beson më shumë. Një gol apo një shans i humbur mund të ndryshojë gjithçka, edhe ndaj kundërshtarëve të fortë. Pas një goli në 'Bernabeu' gjithmonë ka presion të madh. Aty ndodhin gjëra që nuk janë të natyrshme", ka deklaruar Kroos.

Fanella e Messit përfundon në muzeun e FIFA-s

Lionel Messi arriti ta fitonte Kupën e Botës në dhjetor me Argjentinën e tij, ndërkohë që fanella e veshur nga ai në finale dramatike ndaj Francës, tashmë është kthyer në një trashëgimi kulturore. Fanella e Messit do të jetë në muzeun e FIFA-s në Cyrih, aty ku do të ketë shumë kujtime nga Botërori i Katarit, Botërori i cili për herë të parë në histori u zhvillua në dimër dhe jo në verë si gjithmonë. Messi ishte titullar në të gjitha ndeshjet e Botërorit, por në muze do të jetë vetëm fanella që "pleshti" kishte veshur në ndeshjen ndaj Francës, aty ku arriti ta gjente edhe rrugën e rrjetës dy herë duke qenë vendimtar në triumfin me penallti, pasi takimi përfundoi 3-3.

Sommeri zëvendëson Onanan në Inter

Andre Onana pritet t'i bashkohet Manchester Unitedit. "Gazzetta dello Sport" raporton se Interi duket se i ka dhënë fund gjithashtu për portën, duke e gjetur më në fund zëvendësuesin e 27-vjeçarit. Sipas gazetës, Auzilio dhe Marota do të arrijnë marrëveshje me Yann Sommer, menjëherë pas prezantimit të Onanës te "Djajtë e Kuq" që pritet të ndodhë këtë javë. Zvicëranit duket se ka parakaluar portierin ukrainas Trubin dhe do të jetë ai që do ta mbrojë portën e zikaltërve për sezonin e ri.

PSG-ja kërkon Tchouamenin, Barellan dhe De Jongun

Paris SG edhe njëherë tjetër trazon merkaton evropiane. Transferimet e Lucas Hernandez, Marco Asensio, Kang-in Lee dhe Milan Skriniar duket se nuk do ta mbyllin merkaton e kampionëve të Francës. Luis

Enrique duket se ka kërkuar edhe të paktën dy lojtarë të tjerë në këtë merkato, njëri në sulm (mund të jenë dy nëse Mbappe largohet) dhe një tjetër në mesfushë, ku parisenët po mendojnë për lojtarë të Interit, Barcelonas

dhe Real Madridit. Disa objektiva janë të komplikuar, si Tchouameni, lojtar që Real Madridi e ka cilësuar si të paprekshëm, por që në fund mund të përfshihet në operacionin Mbappe. Mbeten në plan të

dytë, por gjithsesi të vlefshëm emrat e Nicolò Barella dhe Frenkie de Jong, që luajnë në dy klube me vështirësi financiare. Një situatë që mund të shfrytëzohet nga PSG-ja për ta bindur Interin dhe Barçën

me oferta të rëndësishme. Dhe flitet për një buxhet marramendës: 100 milionë euro. Është e qartë se nëse francezët do të arrijnë në një shifër të tillë, vështirë se Interi dhe Barça do të refuzonin.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.532/1

Datë: 11.07.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPAR-së, shpallë këtë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës

1. Qendra e Kompetencës në “Shtjefan Gjeçovi”, në Prishtinë ;

Lloji i Vendit të Punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i Pozitave: Një (1) pozitë

Kategoria Funktionale: Nivel drejtues

Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për përzgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton se paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim

ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

II. Titulli i vendit të punës: Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës “Shtjefan Gjeçovi”, në Prishtinë

1. Qendra e Kompetencës “Shtjefan Gjeçovi”, në Prishtinë

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,

Kategoria Funktionale: Nivel drejtues

Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori , është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave.
- Zv. Drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin të të ardhurave;
- Organizimin e kurseve të hapura për punonjësit të ndërmarrjeve të komunitetit lokal;
- Organizim e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të papunëve për tregun e punës në bashkëpunim me zyrën e punësimit;
- Organizimin e panairëve për prezantimin e produkteve të kompanive private dhe publike;
- Dhënie me qira të zyrave me të gjitha pajisjet për bizneset private,;
- Ofrim të shërbimeve këshilluese për ish nxënësit e ndërmarrjeve lokale;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimin dhe punësimit të të gjithë nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit;
- Motivimin për nxënien për të rritur-personeli dhe prindërit;
- Siguron trajnime dhe aftësim që përshtaten nevojave të tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. drejtori i shkollës, menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizatave;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të identifikoj problemet e mundshme dhe mundësit;
- Zv. drejtori i shkollës, siguron që hapësirat e shkollës, pajisjet dhe sistemi mbështetës të funksionoj në mënyrë efektive dhe efikase;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës , përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënësve;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

Titulli i vendit të punës: Zëvendësudrejtor në Qendrën e Kompetencës "Shtjefan Gjeçovi", në Prishtinë
III. në Qendrën e Kompetencës "Shtjefan Gjeçovi", Prishtinë

1. Qendra e Kompetencës "Shtjefan Gjeçovi", në Prishtinë

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. Drejtori i shkollës, kujdeset dhe është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe bashkëpunimin me donatorët dhe institucione rajonale dhe të BE-së,
- Kujdeset për zhvillimin dhe aftësimin pedagogjik dhe profesional të mësimitdhënësve,
- Motivon stafin e mësimitdhënësve që të involvohen në bashkëpunim ndërkombëtarë,
- Kujdeset dhe është përgjegjës për krijimin e grupeve për hartimin e projekteve për institucione ndërkombëtarë,
- Është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në hartimin e projekteve me AAAPARr-në,
- Kujdeset për arritjen në shtetet e BE-së në sferën e AAP-së dhe në përshtatjen e tyre për nevojat e shkollës,
- Bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për përgatitjen e nxënësve për tregun e jashtëm,
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për biznes;
- Zv. drejtori i shkollës, bën matjen dhe vlerësimin: Vlerësimin për të nxënësit dhe Vlerësimin e të nxënësit;
- Zv. drejtori i shkollës, është i obliguar që të mbaj komunikim të vazhdueshëm me palët e ndryshe të interesit;
- Zv. drejtori i shkollës, avokon për mbështetjen e komuniteti për shkollë dhe sistem më të gjerë të arsimit;
- Zv. drejtori i shkollës, inkurajon dhe modelon nxënësin gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe personelin;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të shfrytëzoj burime të ndryshme të informatave për vendimet të cilat ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të njej mundësit e teknologjisë së re dhe asaj në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre të plotë në mbështetje të mësimitdhënies dhe të nxënies;

Kushtet:

